% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi

Dokumenta Standarde të Tenderit

Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES¹

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e

mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a. Kopje të çertifikuara të balanceve të 3 viteve të fundit (2017, 2018, 2019), të paraqitur në Autoritetin Përkatës, DPT- të konfirmuara nga ky autoritet.

- b. Xhiro mesatare vjetore të 3(tre) viteve ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera me satare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.
- c. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore, lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku OE ka ushtruar aktivitetin për 3(tre) vitet ushtrimore (2017, 2018, 2019)

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lartpërmendur.

- d. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike janë në process ankimimi pranë Furnizuesit të Energjisë Elektrike apo në gjykatë. Furnizuesi I energjisë elektrike është I detyruar që të lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.3 Per kapacitetin teknik:

Për sa i përket aftësisë teknike profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

2.3.1 - Përvojë e sukseshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet pa tvsh, të realizuar gjatë 3 viteve të fuundit.*
- b) Punë të ngjashme totale, të kryer gjatë tre viteve të fundit, me vlerë sa dyfishi i vlerës së fondit limit të kontrtës që prokurohet pa tvsh.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të mësipërme e bën ofertën të kualifikueshme.

- ✓ Vlerësimi i përvojës së sukseshme do të Operatorit Ekonomik do të kryehet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:
 - Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9 (Formulari i vlerësimit), shoqëruar me
 - Kontratë, Situacion përfundimtar, Akt kolaudimi, Çertifikata e marrjes në dorëzim të Punimeve dhe Fatura Tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:
Kontratë sipërmarrje, Leje Ndërtimi, Situacion Përfundimtar, Akt Kolaudimi, Faturë Tatimore.

2.3.2 Liçenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP – 1 – A Punime Gërmimi në Tokë

NP – 2 – A Ndërtime Civile dhe Industriale

Dokumenta Standarde të Tenderit

- NP – 3- A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasade
NP – 4 – A Rruge, autostrada, mbikalime...
NP – 12 – B Punime të Inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS – 1 – A Punime për prishjen e ndërtimeve
NS – 2 – A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtje e tyre
NS – 4 – B Punime rafiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rafiniturë me llastik druri etj.
NS – 8 – A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri
NS – 10 – A Shtresa dhe mbistruktura speciale
NS – 12 – A Impiante teknologjike, termike, dhe të kondicionimit
NS – 18 – A Punime topogjeodezike

Sipas modelit të miratuar nga MPPT

Për operatorët e huaj, të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë certifikatat e cilësisë në gjuhën shqipe, ose të përkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme, si më poshtë:

- a) ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)
- b) ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)
- c) OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)
- d) PAS 99 :2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit)
- e) ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor)
- f) SA 8000: 2014 (Për përgjegjësitë sociale të lidhura me personelin)
- g) ISO 50001:2011 (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë)
- h) ISO 27001:2013 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë të Informacionit)
- i) EN ISO 37001: 2016 Sistemi i menaxhimit antirryshfet)
- j) DS CEN TR 15128: 2005 “Riparim i sistemeve të Kanalizimit dhe Kullimit
- k) ISO 3834-2:2006 (Kerkesat e cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalike)

✓ Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht një inxhinier Ndërtimi të stafit teknik i cili të jetë i Çertifikuar për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- ❖ Çertifikatë “Koordinator i Sigurimit Teknik Mbrojtjen dhe Shëndetin në Punë” për inxhinierin
- ❖ Diplomë
- ❖ Kontratë pune, lidhur pranë noterit
- ❖ Librezën e Punës
- ❖ CV përkatëse

Kandidati ofertues duhet të deklarojë me shkrim nga Administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të Punimeve në objekt, person ky i i përfshirë në licencën e shoqërisë. Duhet gjithashtu

Dokumenta Standarde të Tenderit

të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjerë dhe se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Këta drejtues teknikë duhet të jenë të përfshirë edhe në Listëpagesat e shoqërisë sipas formularit të deklarimit dhe të ketë minimalisht 5 vjet punë.

Kjo e provuar me:

- CV përkatëse
- Kontratë pune lidhur pranë noterit
- Diplomë
- Librezë pune

7. Operatorët ekonomikë duhet të kenë një punësim mesatar jo më pak se 60 punëtorë (gjashtëdhjetë) punonjësish, për periudhën Korrik 2019 – Prill 2020, vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Korrik 2019 – Prill 2020.
- b) Listëpagesë e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuara nga administrata tatimore për periudhën Korrik 2019 – Prill 2020, të shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

8. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknikë në licencë dhe të punësuar në shoqëri si më poshtë:

- ✓ Inxhinier Ndërtimi -1
- ✓ Inxhinier Mjedisi – 1
- ✓ Inxhinier Topograf -1
- ✓ Inxhinier ELelektrik -1
- ✓ Inxhinier Mekanik -1
- ✓ Inxhinier Hidroteknik -1
- ✓ Inxhinier Gjeolog -1
- ✓ Inxhinier Infrastruktura Transporti -1
- ✓ Arkitekt -1

Sa më sipër OE duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë, cv, dhe të figurojnë në Listëpagesë.

Në rast Bashkimi të Operatorëve çdo anëtar i grupit duhet të ketë në licencën e tij si drejtues teknikë inxhinierët e mësipërm.

Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e shoqërisë të punësuar dhe në listëpagesë si më poshtë

- ✓ Agronom 1, për Natyrën e Punimeve në Zbatim, për të cilin duhet të paraqesë kontratë

Dokumenta Standarde të Tenderit

Noteriale të punës. Diplomë, dhe të jetë në Listëpagesë 6 muajt e fundit. ***Në rast Bashkimi të Operatorëve çdo anëtar i grupit duhet të ketë në liçencën e tij si drejtues teknikë inxhinierët e mësipërm.***

- ✓ Mjek 1, pajisur me licence për të cilin duhet të paraqesë kontratë Noteriale të punës. Diplomë, dhe të jetë në Listëpagesë, pajisur me Leje për ushtrimin e profesionit, lëshuar nga Urdhri I Mjekut, (të vlefshme) ***Në rast Bashkimi të Operatorëve çdo anëtar i grupit duhet të ketë në liçencën e tij si drejtues teknikë inxhinierët e mësipërm.***
- ✓ Punonjës së Ndhmës së Shpejtë -2, për të cilët duhet të paraqesë Çertifikatë Trajnimi të vlefshme dhe të figurojnë në Listëpagesë.
- ✓ Minimalisht 1 Teknik të Mesëm Ndërtimi shoqëruar me diploma dhe kontratë pune, dëshmi nga ISHTI ose institucione të tjera ekuivalente me të.
- ✓ Minimalisht 22 (njëzetë e dy) punonjës të pajisur me IQT ose Ekuivalente me të, të cilët të figurojnë në listëpagesa. Nga të cilët të jenë të pajisur me IQT sim ë poshtë:
 - 1 Inxhinier Ndërtimi
 - 2 TEknikë Ndërtimi
 - 2 Elektriçistë
 - 3 Hidraulikë
 - 1 Hidroizolues
 - 2 Karpentierë
 - 2 Mekanikë
 - 2 Muratorë
 - 1 Ndërtues
 - 1 Pllakashtrues
 - 2 Saldatorë
 - 3 Suvatues/ Bojaxhinjë

MANovratorë 5 (pesë) të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë. Të figurojnë në Listëagesë. Për Manovratorët dhe punonjësit e mësipërm të pajisur me IQT, OE duhet të paraqesë kontratat e punës dhe Policat e Sigurimit të Aksidenteve Personale.

10. Operatorët Ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet për realizimin me sukses të 3 objekteve, të procedurës së prokurimit. Për këtë duhet të paraqesin:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion, apo mund t' i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për ekzekutimin e kontratës. (Shtojca 10)

MJETE	SASIA/ cope	GJENDJE
Kamiona vetëshkarkues	3	Pronësi ose me qira
Kamioncina	3	Pronësi ose me qira

Dokumenta Standarde të Tenderit

Eskavatorë me zinxhirë	1	Pronësi ose me qira
Eskavatorë më goma	1	Pronësi ose me qira
Autopompë për hedhje betoni	1	Pronësi ose me qira
Betoniere -0,25m ³	6	Pronësi ose me qira
FAdromë (Skrep)	1	Pronësi ose me qira
Autobeoniere	3	Pronësi ose me qira
Motosaldatriçe	1	Pronësi ose me qira
Gjenerator	1	Pronësi ose me qira
Minisekavatorë	2	Pronësi ose me qira
Hekurkthyesë/ PRerëse	1	Pronësi ose me qira
Tabela kantieri	20	Pronësi ose me qira
Kaska Kokore	30	Pronësi ose me qira
Vibratorë	2	Pronësi ose me qira
Tokmak elektrikë	2	Pronësi ose me qira
Matrapik	1	Pronësi ose me qira
Fikëse Zjarri	5	Pronësi ose me qira
Kuti ndihmë e shpejtë	5	Pronësi ose me qira
Karroca dore	10	Pronësi ose me qira
Depozita uji	4	Pronësi ose me qira
Skeleri Ndërtimi	500m ²	Pronësi ose me qira
Pompë suvatimi	2	Pronësi ose me qira
Kontenier Stacioner (zyrë në Objekt)	1	Pronësi ose me qira
Kamion (kokë tërheqëse)	1	Pronësi ose me qira
Rimorkio ose gjysmërimorkio	1	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në Regjistra Publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikat e kontrollit teknik, siguracion (i vlefshëm) çertifikatë transporti lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Për mjetet me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, lidhur kjo pranë noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqitet akt zhdoganimi ose faturë tatimore blerje.
- c) Operatori Ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e praqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe se do të jenë në dispozicion të zbatimit të punimeve në objektin që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendndodhjen e tyre me qëllim verifikimin.
- d) Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe të kontrollojë në çdo kohë deri në përfundim të kontratës mjetet, pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10.
- 11. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë**

Impiant Prodhim Betoni me QKL	1 copë	Pronësi ose me qira
Impiant Prodhim Inertesh me QKL	1 copë	Pronësi ose me qira

Dokumenta Standarde të Tenderit

Për sa më sipër duhet të paraqesin dokumentin e pronësisë apo kontratën e qirasë shoqëruar me leje mjedisore lëshuar nga QKL si më poshtë:

-QKL Leje Mjedisi të Tipit B, Kodi III.1.B. “Për Impiant betoni, prodhim produkteve të betonit, shoqëruar me planvendosjen për impiantin, monitorim mjedisor lëshuar 6 muajt e fundit dhe Çertifikatë Kalibrimi

-QKL Leje Mjedisi të Tipit B, Kodi III.1.B. “Për Impiant Inertesh”

Impianti i prodhimit të betonit nuk duhet të jetë më largë se 55km nga objekti dhe të shoqërohet me planvendosje të nënshkruar nga një topograf vendndodhja e impiantit të betonit.

-Të disponojë liçencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim Mbetje Urbane” .

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria e linjës/ Kontratë shërbimi me subjekt të liçencuar.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin/ njehsimin e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pramë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Republika e Shqipërisë, siç parashikohet në Rregulloren për Kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale në zbatim, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar me VKM Nr.42, Dt. 16.01.2008.

Për Impiantin e Prodhimit të Inerteve dhe Impiantin e Prodhimit të Betonit OE ofertues duhet të paraqesë raport testimet për materialet si më poshtë:

- Raport Testimi të MAterialeve Inerte Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933-1; 2012
- Raport Testimi të MAterialeve Inerte Rërë e LArë, Metoda e Testimit S SH EN 933-1; 2012
- Raport Testimi nga Impianti i prodhimit, metoda e testimit S SH EN 12390 – 1 :3 2009, për mostrën e betonit.
- Raport Testimi nga Impianti i prodhimit i ujit për beton, metoda e testimit S SH EN 1008: 2002
- Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laboratori I akredituar konform S SH ISO/EN 17025: 2006

Raporti I testimet duhet të jetë sipas standardeve në fuqi bazuar në ligjin Nr. 9290 Dt. 07/10/2004 “Për Produktet e Ndërtimit” Raport testimet duhet të jenë të 6mujorit të fundit.

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

-Plan Organizimin e Punimeve në Objekt, shoqëruar me relacion spjegues, ku të reflektojë të gjitha masat tekniko – organizative dhe elementet e tjerë që kërkon një plan organizimi I mirëfilltë.

-Plan I Sigurisë në Kantier, për punimet në object në format sipas VKM nr. 692 Dt. 13.12.2001, “Për masat e veçanta të Sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, ndryshuar me VKM nr 742 Dt. 06.11.2003. Një përshkrim të detajuar të planit të zbatimit të kërkesave për Sigurimin Teknik dhe Shëndetit në punë. Në përputhje me planin e menaxhimit të Sigurimit Teknik dhe Shëndetit në Punë.

-Grafik punimesh, në përputhje me afatin e realizimit të punimeve të kërkuara.

- Vetëdeklarim nga Oeratori Ofertues që Brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/ kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% I kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas liçencës profesionale, të lëshuara nga Autoriteti Kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti I hspalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/ investimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:
Bashkëlidhur DST

Specifikimet Teknike të Materialeve:
Bashkëlidhur DST

Grafiku i Punimeve: 75 ditë, Bashkëlidhur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkëlidhur DST

Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e

Dokumenta Standarde të Tenderit

suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në

Dokumenta Standarde të Tenderit

referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe

shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premteton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të duktshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët

e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

